

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim të përcaktojë të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, si dhe kompetencat e detyrat e organeve shtetërore kompetente për garantimin e kushteve për trajtimin e personave të dënuar me burgim, duke garantuar respektimin e të drejtave dhe të lirive të tyre themelore dhe duke ndaluar, në çdo rast, ndëshkimet apo sjelljet çnjerëzore ose degraduese.

Reformimi i sistemit penitenciar për trajtimin e të dënuarve është një nga prioritetet kyçe të Ministrisë së Drejtësisë, në drejtim të konsolidimit të shtetit të së drejtës, në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti, si dhe të garantimit të të drejtave të njeriut.

Duke qenë se ky projektligj ka për synim mbrojtjen e të drejtave të tyre në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian, aktet ndërkombëtare në fuqi si dhe standardet e pranura ndërkombëtarisht, sjell risitë, si më poshtë vijon:

- a) Krijimin e një regjimi të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me regjim të hapur, një sistem shumëdisiplinar që synon rehabilitimin social për riintegrimin e të dënuarve në jetën familjare, sociale dhe ekonomike, nëpërmjet përfshirjes së burgjeve me regjim të hapur në legjislacionin e posaçëm në sistemin penitenciar. Në këtë mënyrë, kalimi i të dënuarve që përmbushin kriteret ligjore në këto institucione do të shërbejë si një fazë parapërgatitore për çastin e lirimit të tyre. Përgatitja për riintegrim në burgjet me regjim të hapur lehtëson më pas jetën në liri;
- b) Ngritjen e komisionit të vlerësimit të rrezikshmërisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, me qëllim analizën e vlerësimit të riskut të të dënuarve dhe të paraburgosurve për arratisje, riskun e recidivizmit dhe forcimin e masave për ndjekjen e procedurave gjatë dhënies së lejeve shpërblyese, luftës kundër kriminalitetit, terrorizmit dhe ekstremizmit;
- c) Harmonizimin e projektligjit me ligjin nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, përmirësimin e të drejtave të të miturve në burgje dhe zbatimin e parimeve sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;
- ç) Garantimin e rehabilitimit social dhe të riintegrimin në jetën familjare, shoqërore e ekonomike të të paraburgosurve dhe të dënuarve madhorë e të mitur, duke iu garantuar këtyre të fundit format e motivimit nxitës, në

përputhje me parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturit, ndihmën sociale, edukative, arsimore, psikologjike dhe fizike, në përputhje me nevojat individuale dhe në përputhje me grupmoshën, gjininë dhe personalitetin e tij;

- d) Mbështetjen e programeve të kërkimit dhe të vlerësimit rreth funksionimit të sistemit të burgjeve dhe rolit të tij në riintegrimin e të dënuarit në shoqëri.
- dh) Riklasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, mbi bazën e kategorisë që akomodojnë dhe mbi bazën e sigurisë;
- e) Përcaktimin e masave që ndërmerren ndaj shkeljeve disiplinore, procedurës që ndiqet, të organeve kompetente për dhënien e masave disiplinore si dhe ushtrimin e së drejtës së ankimit ndaj masave;
- ë) Përcaktimin e lejeve, të llojeve të lejeve dhe të shpërblimeve për të dënuarit, si dhe të detyrimeve e të përgjegjësisë për shkeljet e kryera;
- f) Parashikimin e procedurave të qarta gjatë shqyrtimit gjyqësor të ankuesve dhe rolit të Avokatit të Popullit;
- g) Parashikimin e rregullimeve për lirim dhe transferimin e të dënuarve madhorë dhe të mitur, duke iu garantuar të dënuarve të mitur të drejtat e tyre në përputhje të plotë me parashikimet ligjore të ligjit nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Propozimi i kësaj nisme legislative vjen si nevojë edhe e përmbushjes së detyrimeve që vijnë nga një sërë aktesh ndërkombëtare, si rregullat evropiane të burgjeve miratuar nga Komiteti i Ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, më 12 shkurt 1987, në mbledhjen e 404-rt të zëvendësministrave dhe rekomandimet e Komitetit Evropian për parandalimin e torturës dhe të trajtimit ose dënimit çnjerëzor dhe poshtërues (KPT).

Këto rekomandime kërkojnë rritjen e garancive ligjore për forcimin e masave të sigurisë dhe identifikimin e nevojave të të burgosurve nëpërmjet vlerësimit të riskut, duke vënë theksin në përmirësimin e kushteve të trajtimit dhe të mbrojtjes të të drejtave për personat e dënuar.

Propozimet për nismën janë kryer në zbatim të rekomandimeve të ekspertëve të huaj të projektit të binjakëzimit “Për reformën në sistemin e burgjeve dhe shërbimin e provës”, mbështetur nga Bashkimi Evropian (IPA 2013), me një fond prej 1 000 000 eurosh, ku një ndër komponentët kryesorë të projektit ishte reformimi i kuadrit ligjor të sistemit të burgjeve sipas standardeve evropiane.

Gjithashtu, qëllim tjetër i këtij projektligji është edhe zbatimi i masave të parashikuara për Ministrinë e Drejtësisë, sipas vendimit nr.246, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2018-2020”. Në këtë plan është parashikuar që Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të vazhdojnë reformimin e sistemit të burgjeve bazuar në këto fusha kyçe:

- Përmirësimi i akteve ligjore dhe nënligjore për sistemin e burgjeve;
- Përmirësimi strukturor dhe organizativ i sistemit të burgjeve;
- Krijimi i një sistemi për të përmbushur nevojat për të burgosurit e rrezikuar;
- Forcimi i sistemit të integritetit dhe të rehabilitimit për të burgosurit.

Ligji ekzistues mbi të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve bën kategorizimin e burgjeve, në burgje të sigurisë së lartë dhe shumë të lartë, të sigurisë së zakonshme dhe të sigurisë së ulët dhe institucione të veçanta.

Por, duke pasur parasysh nevojën e theksuar për krijimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, duke siguruar që të gjitha organet e zbatimit të ligjit të ofrojnë një trajtim njerëzor të personave me liri të kufizuar, duke garantuar dinjitetin e tyre njerëzor dhe shndërrimin e dënimit penal në një mundësi riedukimi, propozohet ky projektligj, nisur dhe nga nevoja për zhvillimin dhe konsolidimin e një strategjie të përshtatshme për garantimin e sigurisë në sistemin e burgjeve dhe për reformimin e sistemit të trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve.

Ky projektligj është i domosdoshëm për vetë rëndësinë që ka, pasi në këtë mënyrë krijohet qëndrueshmëri më e madhe juridike për funksionimin e sistemit të burgjeve dhe garantimin e mbrojtjes të të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve sipas standardeve ndërkombëtare.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është pjesë e programit politik të Këshillit të Ministrave për vitin 2019, miratuar me vendimin nr.764, datë 27.12.2018, të Këshillit të Ministrave, ku është parashikuar edhe miratimi i projektligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, duke krijuar një bazë të plotë ligjore për administrimin dhe menaxhimin e sistemit të burgjeve sipas rregullave evropiane të burgjeve.

Nëpërmjet kësaj nisme synohet përmbushja e objektivave të përcaktuar në programin e qeverisë shqiptare 2017-2021, konkretisht në pikën 3.1 “Shteti ligjor dhe drejtësia e re”, ku parashikohet se:

“Pjesë e rëndësishme e këtij procesi reformimi do të jenë edhe institucionet penitenciare, burgjet dhe paraburgimet, si dhe Shërbimi i Provës, me qëllim rritjen në mënyrë efektive të veprimtarisë së këtyre institucioneve ligjzbatuese në ekzekutimin e vendimeve penale.”.

Ky projektligj është në përputhje dhe me objektivat 6.1, 6.2, 6.3, 6.4, 6.6, 6.7 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017-2020.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji propozohet me qëllim përmbushjen e dy objektivave madhorë:

- a) Forcimin e rendit dhe të sigurisë në sistemin e burgjeve;
- b) Sundimin e ligjit, konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe respektimin, mbrojtjen dhe garantimin e ushtrimit të të drejtave të njeriut në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Nëpërmjet këtij projektligji të propozuar, ky funksion realizohet nëpërmjet procesit të rikategorizimit të burgjeve, mbi bazën e kategorive të individëve që akomodojnë (të dënuar të rritur, të dënuar të mitur, gratë e dënuara dhe të paraburgosurit) dhe mbi bazën e sigurisë së tyre, duke i klasifikuar në: siguri e lartë, siguri e zakonshme, siguri e ulët dhe institucionet e hapura, regjimi i të cilave nuk ka qenë i përcaktuar më parë në legjislacionin ekzistues.

Regjimi i burgjeve të hapura i përgjigjet një sërë problematikave që kanë të bëjnë me efikasitetin e dënimit dhe ekonomizimin e shpenzimeve nga buxheti i shtetit për të dënuarit që vuajnë dënimet në institucionet e tjera të ekzekutimit të vendimeve penale.

Përpos kësaj, është i nevojshëm parashikimi i krijimit të seksioneve të sigurisë shumë të lartë për subjekte me shkallën më të lartë të rrezikshmërisë, duke përcaktuar qartë të dënuarit që kryejnë dënimin në këtë institucion, si dhe përcaktimi i rregullave të qarta që lidhen me regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë. Përgatitja për riintegrim në burgjet me regjim të hapur lehtëson më pas jetën në liri.

Qëllimi i procesit të kategorizimit është për të vlerësuar risqet që paraqet një i dënuar në lidhje me:

- mundësinë për t'u arratisur;
- riskun për të dëmtuar publikun ose shtetin në rast të një arratisjeje;
- çdo çështje tjetër për mbajtjen nën kontroll që ndikon te siguria dhe rregulli i institucionit dhe te siguria e atyre që ndodhen brenda tij.

Rikategorizimi i burgjeve dhe vlerësimi i rrezikshmërisë i përgjigjet një sërë problematikave të identifikuara përgjatë zbatimit të ligjit, që kanë të bëjnë me të dënuarit dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si:

- Lufta kundër kriminalitetit në burgje;
- Analiza faktike dhe situacionale e rrezikut në institucione;
- Forcimi i sigurisë së institucioneve;
- Parandalimi i përfshirjes të të burgosurve në akte korruptive.

Për shkak të problemeve që janë hasur gjatë zbatimit të kuadrit ligjor ekzistues nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ky projektligj synon përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të qarta për shpërndarjen e subjekteve të dënuara me burgim nëpër institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, nëpërmjet vlerësimit të rrezikshmërisë dhe vendosjes në institucione në përputhje me rrezikshmërinë dhe nivelin e sigurisë.

Rregullat evropiane të burgjeve parashikojnë që vetëm masa e dënimit nuk mund të përcaktojë rrezikshmërinë. Kjo pasi risku është një çështje shumëdimensionale.

Në projektligjin e propozuar, në dallim nga parashikimet ligjore ekzistuese, koncepti qendror është menaxhimi i riskut, bazuar mbi një proces të vlerësimit të rrezikshmërisë faktike. Ky proces do të realizohet me anë të formatit të standardizuar të instrumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë, i cili do të hartohet e miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Ky format përdor të dhënat nga vlerësimi i rrezikshmërisë faktike, bazuar në tregues të njohur kriminogjenë, për të arritur në një rezultat të vlerësimit të rrezikshmërisë.

Më pas, ky informacion shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit të rrezikshmërisë, i ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, i cili përcakton rrezikshmërinë dhe, si rrjedhojë, i propozon drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nivelin e sigurisë së zakonshme dhe të ulët që do të mbahet një i burgosur, mbështetur në raportin e vlerësimit të riskut të sigurisë, të hartuar nga IEVP-ja ku i dënuari kryen dënimin e tij. Përpos kësaj, udhëzon/orienton institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për hartimin e planeve individuale për trajtimin e të burgosurit, si dhe masa të veçanta për sigurinë e institucionit.

Domosdoshmëria e ndërhyrjes nëpërmjet kësaj nisme lidhet, gjithashtu, edhe me nevojën e parashikimit përgjatë gjithë përmbajtjes së projektligjit, të dispozitave specifike për trajtimin dhe mbrojtjen e të miturve të dënuar ose të paraburgosur në sistemin e burgjeve, në zbatim të rekomandimeve të Këshillit të Evropës për burgjet, për respektimin dhe garantimin e interesit më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, parashikimi i këtyre rregullimeve ligjore duhet të bëhet në përputhje me parimet dhe dispozitat e ligjit nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, të miratuar rishtazi.

Në drejtim të realizimit të qëllimit tjetër që lidhet me forcimin e shtetit të së drejtës, në kuptim të respektimit dhe të ushtrimit të të drejtave të natyrës procedurale dhe materiale të të paraburgosurve dhe të dënuarve, është e nevojshme ndërhyrja me qëllim reformimin terësor të trajtimit të tyre. Në këtë mënyrë, në projektligj është parashikuar mbrojtja e të drejtave, në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian, aktet ndërkombëtare në fuqi si dhe standardet e pranuar ndërkombëtarisht. Të burgosurit dhe të paraburgosurit duhet të trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat themelore të tyre, duke ndaluar në mënyrë kategorike çdo sjellje çnjerëzore ose degraduese, si dhe ndëshkimet. Në projektligj është parashikuar trajtimi i diferencuar i të dënuarve, me qëllim realizimin e funksionit riedukues të dënimit, kufizimet individuale dhe në grup të të drejtave, vetëm në raste dhe sipas kritereve të përcaktuara në këtë projektligj, duke shmangur interpretimet e ndryshme që çojnë në keqzbatim të projektligjit.

Rëndësi thelbësore i është kushtuar trajtimit të të burgosurve, i cili në çdo rast duhet të synojë rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike, duke përcaktuar programe individuale riedukimi. Nëpërmjet këtyre parashikimeve ligjore synohet të përforcohet dhe të inkurajohet kuptimi më i mirë në publik i rolit të sistemit të burgjeve, në trajtimin e të dënuarve, përmes informimit të vazhdueshëm të publikut nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Gjithashtu, në projektligj është parashikuar se Ministria e Drejtësisë do të mbështesë programe kërkimi dhe vlerësimi rreth funksionimit të sistemit të burgjeve si dhe rolit të tij në riintegrimin e të dënuarit në shoqëri.

Duke mbajtur në konsideratë situatën faktike në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, lidhur me jetesën e të dënuarve në institucion, për shkak të mbipopullimit të tyre, janë parashikuar rregulla të qarta, sipas standardeve ndërkombëtare, lidhur me mjediset e qëndrimit dhe të fjetjes, veshjet dhe pajisjet, higjienën vetjake dhe të mjedisit, ushqimin, kohën e ajrimit, shërbimin mjekësor e të tjerë. Trajtimi i të dënuarve dhe të paraburgosurve bëhet duke siguruar mjediset dhe mjetet e përshtatshme, si dhe në përputhje me të dhënat e personalitetit të tyre.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Në përputhje me nenin 26, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ministri i Drejtësisë është autoriteti i deleguar për propozimin e këtij projektligji. Ndaj edhe nisma e propozuar paraqitet si një iniciativë, për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Projektligji është në përputhje me parimin kushtetues dhe ligjor të shtetit të së drejtës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE TË BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji ndonëse është përfshirë në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2019–2021, të miratuar me vendimin nr.201, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, nuk synon përafrimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së, për shkak se rekomandimet ReC (2006)2 të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Për rregullat evropiane në burgje”¹, të cilat kanë shërbyer si referim për hartimin e këtij projektligji, nuk kanë karakter detyrues, por shërbejnë si një instrument fleksibël të së drejtës komunitare për të përshtatur objektivat e politikave kombëtare në drejtim të politikave evropiane.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Pjesa e parë- Dispozita të përgjithshme

Kreu I- Objekti

Ky kre parashikon objektin e projektligjit që përcakton të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurit dhe të dënuarve me burgim, kompetencat dhe detyrat e organeve shtetërore kompetente, si dhe duke pasur parasysh nevojën e përdorimit të termave të posaçëm është parashikuar një dispozitë e cila përmban përkufizimet e nevojshme, për qëllime të këtij projektligji. Gjithashtu, në këtë kre janë parashikuar kategoritë e subjekteve që i nënshtrohen rregullave të këtij projektligji, si dhe vuajtja e dënimeve me burgim bëhet vetëm në vendet e caktuara posaçërisht, sipas këtij projektligji.

Kreu II-Parimet themelore

Kreu II parashikon respektimin e të drejtave themelore të njeriut, duke përcaktuar trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve, pa baza diskriminimi. Të paraburgosurit dhe të dënuarit që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale, para ose gjatë qëndrimit në institucion, i ofrohen masa të menjëhershme mbrojtjeje, mbështetjeje dhe këshillime ligjore, me qëllim rehabilitimin e tyre. Në rastet e dhunës ndaj grave dhe të miturave, mbahen parasysh nevojat specifike gjinore të tyre.

Gjithashtu, parashikohet trajtimi i diferencuar i të dënuarve, nëse është i nevojshëm me qëllim realizimin e funksionit riedukues të dënimit, në varësi të

¹ Miratuar nga Këshilli i Ministrave me 11 janar 2006, në takimin e 952-të të Zëvendësministrave)

sigurisë së institucionit të vuajtjes së dënimit. Trajtimi i diferencuar nuk do të konsiderohet diskriminim dhe as trajtim çnjerëzor apo degradues.

Kufizimi individual dhe në grup i të drejtave bëhet në rastet dhe sipas kritereve të parashikuara në projektligj. Të drejtat e të paraburgosurit dhe të të dënuarve mund të kufizohen ose të hiqen përkohësisht në grup, me urdhër të ministrit të Drejtësisë, vetëm në kushtet e situatave të emergjencës, në atë masë dhe për aq kohë sa përcaktohet në urdhër.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të bëjnë ankime, drejtuar organeve kompetente, lidhur me zbatimin e projektligjit dhe të rregullave të brendshme në formën që përcaktohet në këtë projektligj dhe në mënyrë individuale.

Po kështu, në këtë kre janë parashikuar veprat penale të kryera nga të burgosurit dhe të paraburgosurit, hetimi i të cilave zhvillohet dhe trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kreu III-Trajtimi

Kreu III i projektligjit përmban parashikime të rëndësishme lidhur me trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, në funksion të rehabilitimit për riintegrimin në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Përgatitja për riintegrim fillon në paraburgim, vazhdon gjatë kryerjes së dënimit dhe pas lirimit nga burgu. Për të miturin e dënuar parashikohet ndihmë sociale, edukative, arsimore, psikologjike, mjekësore dhe fizike për riintegrimin e tij, në përshtatje me nevojat individuale dhe në përputhje me grupmoshën, gjininë dhe personalitetin e tij. Trajtimi i të paraburgosurit dhe i të dënuarve duhet të bëhet sipas kriterit të individualizimit, në përputhje me gjendjen dhe karakteristikat individuale të secilit të dënuar.

Për çdo të paraburgosur dhe të dënuar hartohet plani i riintegrit, ndërsa për kategoritë e veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve hartohet programi individual i trajtimit, duke mbajtur parasysh edhe nevojat specifike të tyre dhe një rëndësi e veçantë i kushtohet trajtimit psiko-social të të paraburgosurve dhe të dënuarve të mitur, të rinjve 18 deri 21 vjeç, grave, personave me çrregullime të shëndetit mendor, të pasura ose të fituara gjatë burgimit, personave me aftësi të kufizuara, personave me orientim seksual të ndryshëm, personave me sëmundje kronike ose në varësi të drogës, të moshuarve, personave të dënuar me dënime afatgjata, personave që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi.

Ndërkohë për të miturit të paraburgosur ose të dënuar përgatitet një plan individual riedukimi, i cili merr në konsideratë arsimin e tij, vlerësimin psikologjik, situatën emocionale, dëshirat dhe mundësitë e tij/saj për të ndjekur kurse profesionale ose për të avancuar në arsim.

Në projektligj është parashikuar se Ministria e Drejtësisë mbështet programe kërkimi dhe vlerësimi rreth funksionimit të sistemit të burgjeve, rolit të tij në riintegrimin e të dënuarit në shoqëri.

Pjesa e dytë- Institucionet

Kreu I - Llojet e institucioneve

Në këtë kre janë parashikuar institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale, mbi bazën e kategorisë që akomodojnë dhe mbi bazën e sigurisë. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale mund të ndahen në seksione sipas nevojës së administrimit. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janë publike dhe private.

Gjithashtu, janë parashikuar institucionet e sigurisë së lartë, llojet e vendimeve me burgim që ekzekutohen në këtë institucion, regjimi i posaçëm që ndiqet në burgun e sigurisë së lartë, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së zakonshme, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së ulët, institucionet e paraburgimit, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për gratë dhe të miturit dhe institucionet e hapura, duke përcaktuar të dënuarit që vuajnë dënimin në këto institucione të ekzekutimit të vendimeve penale. Institucionet e hapura janë institucione ku vuajnë dënimin të dënuarit me burgim, që u kanë mbetur më pak se 6 muaj burgim dhe që bazuar në raportin e komisionit të vlerësimit të rrezikshmërisë të të dënuarve nuk përbëjnë risk sigurie për institucionin apo komunitetin dhe të dënuarit me gjysmë liri.

Brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale krijohen seksione të veçanta për vendosjen e personave, të paraburgosur ose të dënuar, që gëzojnë statusin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Kreu II- Organet drejtuese të burgjeve

Ky kre ka parashikuar në dispozitat e tij Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, komisionin e vlerësimit të rrezikshmërisë të të dënuarve që ngrihet në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, përbërjen dhe detyrat e tij.

Ngritja e komisionit të vlerësimit të rrezikshmërisë të të dënuarve është një kërkesë e rregullores evropiane për të përcaktuar vlerësimin e rrezikshmërisë faktike të të dënuarve që pranohen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Në projektligjin e propozuar koncepti qendror është menaxhimi i riskut, bazuar në tregues të njohur kriminogjenë, për të arritur në një rezultat të vlerësimit të rrezikshmërisë. Më pas ky informacion shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit të rrezikshmërisë të të dënuarve, i cili përcakton rrezikshmërinë dhe si rrjedhojë vendos nivelin e sigurisë së zakonshme dhe të ulët që do të mbahet një i burgosur. Gjithashtu, komisioni i vlerësimit të rrezikshmërisë të të dënuarve udhëzon/orienton institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për hartimin e planeve individuale për trajtimin e të burgosurit, si dhe masa të

veçanta për sigurinë e institucionit. Komisioni interviston të dënuarin në çdo rast kur duhet të vendosë për ndryshimin e trajtimit të tij dhe e reflekton këtë fakt në raportin e vlerësimit të rrezikshmërisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve harton dhe miraton një format të standardizuar për të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të instrumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë.

Në projektligj parashikohet edhe personeli i institucionit, i cili garanton sigurinë dinamike, i cili i njeh të burgosurit që janë nën kontrollin e tyre. Për garantimin e interesit më të lartë të të miturit, institucioni përkatës i paraburgimit ose i burgimit duhet të ketë personel të mjaftueshëm, të përzgjedhur me kujdes, të specializuar dhe të trajnuar në vazhdimësi, në mënyrë që t'u sigurojë të miturve një rol dhe model pozitiv.

Përpos sa më sipër, parashikohet edhe organi i Policisë së Burgjeve dhe misioni i tij ligjor.

Kreu III- Kushtet e jetesës në institucion

Kreu III ka parashikuar kushtet e jetesës në institucion të të paraburgosurve e të dënuarve dhe kërkesat e domosdoshme për mjediset që jetojnë të dënuarit, lidhur me ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, mjediset e qëndrimit dhe të fjetjes, ku mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale por, në çdo rast, duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m², për çdo të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar. Drita artificiale duhet të plotësojë standardet teknike, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Të paraburgosurve apo të dënuarve u sigurohet energji elektrike e nevojshme për ndriçim dhe nevoja të higjienës personale.

Këto kushte sigurohen edhe kur në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ka raste të mbipopullimit. Ky kre përmban parashikime lidhur me veshjet e pajisjet, higjienën vetjake dhe të mjedisit, ushqimin dhe kohën e ajrimit.

Parashikime të tilla në projektligj vijnë si nevojë e përshtatjes së këtij projektligji me kërkesat e rregullores evropiane të burgjeve.

Pjesa e tretë- Pranimi dhe trajtimi i të dënuarve në institucion

Kreu I-Pranimi

Në këtë kre parashikohet pranimi në institucion i të paraburgosurve dhe i të dënuarve, procedura që ndiqet si dhe diferencimi i institucioneve për qëllime trajtimi, caktimi dhe grupimi i të dënuarve.

Në kuadër të përshtatjes së këtij projektligji me kërkesat e rregullores evropiane të burgjeve, propozohet se kur ka një skemë të njohur të ndihmës ligjore falas,

organet e burgut ia bëjnë këtë gjë të ditur të dënuarve. Ky parashikim synon të ofrojë mundësi për të përfituar ndihmë juridike falas, si një mjet për të garantuar akses në drejtësi, për të gjithë ata që përmbushin kriteret e përcaktuara në ligjin nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Kreu II- Drejtimit dhe format e trajtimit

Ky kre përmban parashikime të nevojshme lidhur me trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, në përputhje me të dhënat e personalitetit të tyre. Në të gjenden të parashikuara format e motivimit nxitës për të dënuarin e mitur, në kuadër të respektimit të parimit për mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturit, kur i mituri tregon një sjellje shembullore dhe të denjë, përfshirje në programet edukative dhe aktivitetet e zhvilluara në mjedisin e vuajtjes së dënimit për të mitur.

Në projektligj janë parashikuar në mënyrë të detajuar drejtimit e trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve, në lidhje me shërbimin mjekësor, kujdesin shëndetësor të ofruar për kategori të veçanta, punësimin, arsimimin, veprimtaritë kulturore, çlodhëse e sportive, mjediset dhe kushtet materiale të trajtimit.

Kujdes i veçantë i është kushtuar ruajtjes, përmirësimit ose rivendosjes së lidhjeve të të paraburgosurit dhe të të dënuarve me familjen, takimeve, vizitave, korrespondencave dhe informacionit si dhe të drejtës së besimit dhe ushtrimit të riteve fetare.

Pjesa e katërt- Regjimi në institucion

Kreu I- Normat e sjelljes, zhdëmtimi dhe përgjegjësia disiplinore

Në këtë kre janë parashikuar rregullime ligjore për normat e sjelljes të të paraburgosurve dhe të dënuarve, përgjegjësia për dëmet e shkaktuara. Gjithashtu, është parashikuar kontrolli vetjak i të dënuarve dhe të paraburgosurve, duke respektuar dinjitetin e të paraburgosurit dhe të dënuarit, në çdo rast të hyrjes apo të daljes nga institucioni, dhe në raste të tjera, kur ka shkaqe të arsyeshme; kontrolli në mjediset e banimit (dhoma/qeli); kontrolli vetjak i vizitorëve dhe personelit sipas rasteve dhe procedurave të parashikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe shoqërimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve.

Përveç parashikimeve ligjore të mësipërme, është përcaktuar e drejta e të paraburgosurit dhe e të dënuarit për të paraqitur kërkesa ose ankesa, si dhe trajtimi i tyre, dhe afatet e shqyrtimit.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar rregullave të disiplinës, shkeljeve disiplinore, masave disiplinore që zbatohen, organeve kompetente për masat disiplinore si dhe procedurës që ndiqet për dhënien dhe zbatimin e tyre, duke përcaktuar edhe të drejtën e ankimit dhe mënyrën e ushtrimit të saj ndaj

kundërshtimit të masave disiplinore, pranë organeve apo strukturave përgjegjëse.

Si garanci për të dënuarit e mitur është parashikuar se nuk mund të merren masa disiplinore asnjë lloj dënimi/ndëshkimi fizik ose trupor, heqje ose kufizim i kujdesit shëndetësor. Masat disiplinore që merren ndaj të miturit nuk duhet të sjellin shkeljen apo cenimin e dinjitetit të tij, trajtimin e egër, çnjerëzor, degradues apo dëmtimin e shëndetit të tij fizik ose mendor.

Në kuadër të përshtatjes me kërkesat e rregullores evropiane të burgjeve, ndalohet dhënia e masës së disiplinës dy herë për të njëjtin akt ose të njëjtën sjellje për të cilën është shprehur më parë me vendim organi kompetent disiplinor.

Në këtë kre është parashikuar edhe regjimi i mbikëqyrjes së veçantë në të cilin mund të vendosen të paraburgosurit dhe të dënuarit për një periudhë jo më të gjatë se 3 muaj, kur rrezikojnë sigurinë për personelin e burgut, vizitorët; kur ka rrezik të dëmtojnë veten ose të tjerët; ka rrezik të pengojnë veprimtarinë e të paraburgosurve ose të dënuarve të tjerë nëpërmjet dhunës ose kërcënimeve; ka rrezik të detyrojnë të paraburgosurit ose të dënuarit e tjerë që t'iu nënshtrohen ose të përfitojnë prej tyre ose ka rrezik të nxisin të tjerët të mos zbatojnë ose të shkelin rregullat, individualisht ose në grup. Regjimi i mbikëqyrjes së veçantë vendoset me urdhër të drejtorit të institucionit. Ky i fundit urdhëron drejtpërdrejt për kalimin e të paraburgosurit ose të dënuarit në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, duke vënë menjëherë në dijeni për këtë prokurorin dhe drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve. I dënuari, i paraburgosuri ose mbrojtësi ka të drejtë të ankimojë urdhrin e drejtorit të institucionit në gjykatë. Ky regjim zbatohet në ambientet e brendshme të institucionit ku ndodhet i dënuari apo i paraburgosuri.

Nuk lejohet përdorimi i forcës fizike ndaj të paraburgosurit dhe të dënuarve, nëse nuk është e domosdoshme për të ndaluar aktet e dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni, si dhe për mposhtjen e kundërshtimit edhe kur ai është pasiv, në zbatimin e urdhrave të dhënë. Në rregulloren e burgjeve përcaktohen llojet, natyra e forcës dhe e mjeteve të shtrëngimit dhe rregullat e përdorimit të tyre me funksion parandalues e në përputhje me individualitetin e të të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Kreu II- Lejet, shpërblimet dhe ndryshimi i gjendjes civile

Ky kre përmban parashikime ligjore që përcaktojnë lejet shpërblyese që kanë të drejtë të marrin të dënuarit e rritur dhe të dënuarit e mitur, ku për këta të fundit kohëzgjatja e lejeve shpërblyese në total nuk mund të jetë më shumë se 60 ditë në vit. Drejtori i institucionit mund t'u japë të paraburgosurve dhe të dënuarve leje të veçantë, në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, apo të ngjarjeve të

rëndësishme familjare, si vdekje, lindje apo martesë si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit. I paraburgosuri dhe i dënuari është i detyruar të respektojë kohën e lejes, ta kryejë atë në vendin për të cilën i është dhënë, të respektojë të gjitha detyrat dhe kushtëzimet që i janë dhënë dhe të njoftojë institucionin për çdo shmangie të imponuar.

Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit.

Drejtoria e institucionit i evidenton në një regjistër të veçantë faktet e lindjeve, të martesave apo të vdekjeve të ndodhura në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, si dhe informon autoritetet përgjegjëse, për të bërë shënimet përkatëse në regjistrin e posaçëm të gjendjes civile, në të cilin nuk pasqyrohet statusi i personit si i burgosur.

Në projektligj, në fund të këtij kreu parashikohet që i dënuari mund të disponojë depozitën sipas ligjit dhe kriterëve të parashikuara në rregulloren e burgut.

Kreu III- Transferimet dhe lirimi

Në këtë kre janë përcaktuar rregullat e transferimit dhe të lirim të të dënuarve.

Transferimet bëhen për arsye të rënda sigurie, kur rrezikohet jeta ose shëndeti i të dënuarit nga të tjerët, kur ka mbipopullim në institucion, për nevoja të hetimit dhe gjyqimit, për shkaqe shëndetësore dhe familjare, si dhe kur për shkak të formimit profesional është i nevojshëm në një institucion tjetër si dhe në zbatim të urdhrat të ekzekutimit të prokurorisë për vendimet e formës së prerë të gjykatës. Transferimet duhet të favorizojnë mundësi që të dënuarit ta kryejnë dënimin pranë vendbanimeve të familjeve të tyre.

Për sa i përket transferimit të të miturve, në projektligj parashikohet se për personat e mitur që arrijnë moshën madhore dy muaj para lirim të tyre, autoritetet kompetente duhet të shqyrtojnë, rast pas rasti, për mostransferimin e tyre në institucionet e vuajtjes së dënimit për të rritur. Përpara transferimit i mituri i nënshtrohet një ekzaminimi mjekësor.

Pjesa e pestë- Shqyrtimi gjyqësor i ankimeve dhe roli i Avokatit të Popullit.

Në këtë kre parashikohet procedura dhe shqyrtimi gjyqësor i ankimeve nga gjykatat. Mënyra e procedimit nga gjykata bëhet sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale. Shqyrtimi i ankimit ndaj vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë do të bëhet sipas rregullave të përgjithshme të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Vendimet e formës së prerë, që jepen nga gjykata, ekzekutohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale.

Në projektligj parashikohet të japë kontribut të rëndësishëm edhe mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës, të trajtimit ose të dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, duke sanksionuar kompetencat e tij, garancitë në veprimtarinë e mekanizmit kombëtar, format e realizimit të mbikëqyrjes, duke marrë edhe specialistë të fushave përkatëse për realizimin e procesit të mbikëqyrjes.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale marrin masa për zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar një nivel sigurie të plotë gjatë përpunimit dhe ruajtjes së tyre.

Përpos rregullimeve ligjore të mësipërme, në projektligj parashikohet inspektimi nga institucionet shtetërore.

Ministria e Drejtësisë, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve janë organet kompetente shtetërore për kryerjen e inspektimeve pranë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

Personat e autorizuar, me urdhër nga ministri i Drejtësisë apo drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, gëzojnë të drejtën të inspektojnë burgjet dhe të bëjnë verifikime me objekt të përgjithshëm apo tematik. Objekti i verifikimeve të inspektimit janë vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve apo të paraburgosurve, si edhe çështjet konkrete të përcaktuara në urdhrin e inspektimit. Pas përfundimit të inspektimit, personat e autorizuar për kryerjen e inspektimeve, përgatisin rekomandimet, sipas rastit, për Ministrin e Drejtësisë apo Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, lidhur me marrjen e masave të nevojshme për shkeljet e konstatuara.

Pjesa e gjashtë-Trajtimi i të paraburgosurve

Rregullat në këtë pjesë të projektligjit parashikojnë mbrojtje shtesë të personave të vendosur në institucione të paraburgimit ose seksione të paraburgimit, duke parashikuar të drejtat e tyre, të drejtën e këshillimit ligjor, të drejtën e përfitimit të lejes shpërblyese.

Në asnjë rast të paraburgosurit nuk trajtohen si të dënuar ose si persona që mund të dënohen në të ardhmen. Personat e paraburgosur gëzojnë të gjitha të drejtat që gëzojnë edhe të dënuarit me burgim.

Në pjesën e fundit të projektligjit janë parashikuar dispozitat e nxjerrjes së akteve nënligjore, dispozita tranzitore, shfuqizimet dhe hyrja në fuqi e projektligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet dhe organet që ngarkohen me zbatimin e këtij projektligji janë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale si edhe Ministria e Drejtësisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe me ndihmën e ekspertëve vendas.

Në zbatim të ligjit nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, projektligji është hedhur në faqen për konsultim publik në datën 11.3.2019, me qëllim marrjen e mendimeve apo të sugjerimeve nga ana e institucioneve apo grupet e interesit. Me kalimin e afatit 20 (njëzet) ditë nga publikimi i tyre të përcaktuar në ligj, nuk u përcoll asnjë koment mbi përmbajtjen apo fushën e veprimit të projektligjit dhe të relacionit shoqërues nga ana e institucioneve apo grupet e interesit.

Projektligji ka qenë në proces konsultimi në datat 11 – 12 prill 2019, tryeza konsultimi të organizuara pranë Ministrisë së Drejtësisë, për konsultimin e projektligjeve të sistemit penitenciar me të gjithë aktorët e interesuar dhe disa përfaqësues të institucioneve, të cilët shprehën mendimet dhe sugjerimet e tyre mbi projektligjin.

Paketa e projektligjeve të sistemit penitenciar, pjesë e së cilës është edhe ky projektligj iu dërgua për mendim Prokurorisë së Përgjithshme, Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Këshillit të Evropës, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezencës në Shqipëri (OSCE) dhe Misionit EURALIUS.

Në vijim të procesit të konsultimit mendimet dhe komentet e përcjella nga Misioni EURALIUS, Avokati i Popullit, KDPM-ja, QSHRT-ja në rrugë elektronike, si dhe mendimet nga Prokuroria e Përgjithshme, prezenca e OSBE-së në Shqipëri u morën në konsideratë gjatë hartimit të këtij projektligji.

Ky projektligj iu dërgua për mendim nëpërmjet sistemit *e-aktet* Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Në vijim të shpjegimeve në krerët më lart sqarojmë se me vënien në funksion të IEVP-së Shkodër dhe të dy godinave të reja në IEVP-në “Jordan Misja” aktualisht kemi një nënpopullim në institucionet e ekzekutimit të vendimeve. Ngritja e standardeve në përfrim me standardet evropiane ka bërë të

panevojshme deri më tani hapjen e institucioneve private. Megjithatë, vijimi i mbajtjes së këtij standardi mund të krijojë në të ardhmen nevojën për mbylljen e disa institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, të cilat nuk do të jenë në nivelin e duhur dhe për pasojë krijimin në këtë mënyrë të një mbipopullimi të tyre, gjë e cila mund të sjellë nevojën e hapjes së këtyre institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale në të ardhmen.

Për sa më lart vlerësojmë se ky standard duhet të vijojë të parashikohet edhe në këtë projektligj që po hartohet dhe se mund të lind nevoja për t'u zbatuar në vitet në vijim.

Në lidhje me sugjerimin e dytë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka hartuar analizën e mëposhtme për sa kërkohet:

Për periudhën janar-dhjetor 2018 janë trajtuar mesatarisht 5 411 të burgosur në të gjitha IEVP-të, prej të cilëve 3 082 të dënuar dhe 2 329 të paraburgosur. Mbiipopullimi ka qenë mesatarisht 3%. Gjatë tre muajve të fundit të vitit 2018 mbiipopullimi në IEVP ka shënuar 0%, i cili ka ardhur si rrjedhojë e vënies në funksion të IEVP-së Shkodër.

Me vënien në funksion të IEVP-së Shkodër, (institucion i inauguruar në datën 1.8.2018 dhe i vënë në funksionim të plotë në datën 5.10.2018) kapaciteti akomodues i sistemit të burgjeve nga 5 455 vende ka shkuar në 6 236.

Në muajin prill 2019 kapacitetet e sistemit të burgjeve janë rritur nga 6 236 vende në 6 366, si rrjedhojë e vënies në funksion të plotë të dy godinave të reja në IEVP-në “Jordan Misja”.

Në maj të vitit 2019 kapacitetet e burgjeve kanë ndryshuar si rrjedhojë e rikonstruksionit të dy godinave, A dhe B, në IEVP-në Lezhë dhe adaptimin në ambiente spitalore. Pra, këto dy godina nuk do të shërbejnë për trajtimin e të burgosurve, por për personat me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Si rezultat, numri i vendeve të këtyre godinave nuk numërohet në kapacitetin total për personat në statusin e të paraburgosurve apo të dënuarve.

Aktualisht, kapacitetet totale të sistemit të burgjeve janë 6 106 vende. Sipas të dhënave më të fundit numri i të burgosurve është 5 171, prej të cilëve të paraburgosur 2 168 dhe të dënuar 3 003.

Nëse do të bëjmë një vlerësim të përgjithshëm të situatës së institucioneve penitenciare vihet re se ka një përmirësim të dukshëm të kushteve të trajtimit të personave me liri të kufizuar. Një nga problemet kryesore të sistemit të burgjeve siç është mbiipopullimi është eliminuar plotësisht dhe, aktualisht, ndodhemi në kushtet e nënpopullimit të burgjeve, -680 vende, ose -11%. Eliminimi i mbiipopullimit në burgje ka ardhur si rezultat i masave konkrete, qoftë në investime, si hapja e burgut të ri në Shkodër, investim i Bashkimit Evropian dhe qeverisë shqiptare, si dhe ndërtimi i dy godinave të reja në IEVP-në “Jordan Misja”, Tiranë, investim i qeverisë shqiptare, ashtu edhe përmes kryerjes, rast

pas rasti, të një studimi të kujdesshëm të shpërndarjes dhe të akomodimit të të burgosurve në IEVP, duke pasur në konsideratë, si më poshtë vijon:

- Garantimin e së drejtës sipas kriterit të vendqëndrimit të tyre në një IEVP sa më afër vendbanimit;
- Nevojat e realizimit të procedurës së hetimit penal dhe të gjykit me kosto sa më të ulët (kohë dhe shpenzime) si dhe për një risk sigurie sa më të ulët;
- Kapacitetin dhe normën e popullimit në paraburgimet më të afërta.

Ulja e mbipopullimit në nivel të përgjithshëm ka sjellë ndikim pozitiv sa i përket trajtimit të personave me liri të kufizuar, përmirësimin e regjimit të të burgosurve dhe të kushteve në të cilat trajtohen, rritjen e orëve të ajrimit, si dhe cilësinë e përgjithshme të aktivitetit ditor.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE